



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Urdhërit nr. 20 datë 19.01.2018, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “ Për krijimin e sporteve unike të shërbimeve për fermerët – “Agropika”, AZHBR shpall njoftimin e punësimit për:

SPECIALIST INFO - APLIKIM

PËR AGROPIKAT:

**LUSHNJË, VLORË, MAT, KUKËS, LEZHË, SARANDË, ELBASAN, TIRANË,
KAVAJË, LIBRAZHD, PËRMET, BERAT, PUKË, POGRADEC, DIBËR,
GJIROKASTËR dhe SHKODËR**

Detyrat kryesore të Specialistit Info-Aplikim janë:

- Të japë informacion dhe të promovojë programet e skemave mbështetëse kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural.
- Të japë informacion dhe të promovojë programet e skemave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural të financuar nga Bashkimi Evropian (IPARD II), si dhe donatorë të tjerë.
- Të japë informacion mbi Fondet e Garancisë dhe lehtësirat financiare që ofrojnë tregjet bankare dhe financiare për fermerët.
- Të japë informacion mbi politikat e zhvillimit të sektorit bujqësor dhe blegtoral.
- Të japë informacion mbi tregjet bujqësore dhe blegtorale.
- Të kryejë regjistrimin e të dhënave të fermës bujqësore dhe blegtorale sipas sistemeve të vëna në funksion.
- Të bëjë pranimin e aplikimeve për mbështetjen financiare nga fondet e skemave kombëtare.

- Të bashkëpunojë me zyrat shtetërore, bashkitë, bankat, donatorët apo grupet e fermerëve/ shoqatave për ofrimin e shërbimeve.
- Të raportojë pranë AZHBR qendër në mënyrë periodike.
- Të raportojë problematikat apo idetë dhe kërkesat e fermerëve.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë universitar, niveli Bachelor.
(Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë përvojë pune ose internshipi.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës **23.11. 2018, ora 12.00** në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, kërkesën për punësim, një kopje të CV të përditësuar, certifikata të kualifikime të ndryshme, një fotokopje e librezës së punës, një kopje të ID.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë